



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.07.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AGRO INVEST 1" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale ", Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " AGRO INVEST 1" SH.P.K., e dt.29.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale ", Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 23.07.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Përmirësohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 23.07.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " AGRO INVEST 1" SH.P.K., me dt.29.07.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale ", Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.07.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesat e juaja janë pjesërisht të bazuara.

Hiqet nga Lista pajisja Gjysmë rimorkio me kompresor ajri, ndërsa pajisjet tjera siq janë:

- Cilindër hidraulik me gjemba që montohet në eskavator ose lugë ngarkuese me kapacitet deri në 500 kg;
- Kamion automikser për bartjen e betonit të gatshëm;
- Autopompë për hedhjen e betonit me gjatësi minimale 25 m;
- Minieskavator me kapacitet nga 3 t deri në 5 t;

janë të nevojshme duke pasur parasysh natyrën e punës dhe terrenin ku do të kryhet punimet sipas përshkrimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Te gjitha palëve të interesuara;

